



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 mars 2024
Nr. Ref.:RK 2399/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI87/23

Parashtrues

Shpejtim Bokshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
ARJ.nr.113/22, të 27 dhjetorit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Shpejtim Bokshi nga Gjakova, i përfaqësuar nga Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston Aktgjykimin [ARJ.nr.113/22] e Gjykatës Supreme, të 27 dhjetorit 2022.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kérkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kérkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrotjfen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kérkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kérkesës] dhe 47 [Kérkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. o3/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 prill 2023, parashtruesi i kérkesës përmes postës e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), e cila arriti dhe u regjistrua në Gjykatë më 25 prill 2023.
6. Më 3 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [Nr.GJR.KI87/23], caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi – Peci gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [Nr.KSH.KI87/23], Kolegjin shqyrtyes të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gérxhaliu – Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 5 maj 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit për regjistrimin e kérkesës dhe kérkoi nga ai që të paraqesë autorizimin përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 16 maj 2023, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kérkesës dorëzoi autorizimin e kérkuar në Gjykatë.
9. Më 20 korrik 2023, një kopje e kérkesës i është dërguar Gjykatës Supreme.
10. Më 30 janar 2024, Kolegji shqyrtyes shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e faktave

11. Parashtruesi i kérkesës parashtron për herën e dytë kérkesë para Gjykatës, ku për herën e parë kishte parashtruar kérkesën KI85/20. Gjykata do të reflektojë faktet e rastit KI85/20, për aq sa ndërlidhen me kérkesën e tanishme KI87/23.

12. Në lidhje me kërkesën KI85/20 ishin zhvilluar tri procedura të ndryshme para autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, dhe atë: i) procedura përmbarimore, ii) procedura penale dhe iii) procedura sipas padisë për anulimin e Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejmë KPMM), nr. 3777, të 31 gushtit 2017. Në kërkesën KI85/20 parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 4273/19, të 5 shkurtit 2020, duke kontestuar kushtetutshmërinë e procedurës përmbarimore si dhe kishte paraqitur kërkesë për masë të përkohshme. Kërkesën e parë KI85/20, Gjykata e shpalli të papranueshme si dhe e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.
13. Gjykata rikujton se procedura për anulimin e Aktvendimit nr.3777, të KPMM-së, të datës 31 gusht 2017, u nis fillimisht nga parashtruesi i kërkesës me padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Megjithatë, Gjykata Themelore, duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit, ndërprenë këtë procedurë pasi ishte duke u zhvilluar një procedurë penale në të njëjtën gjykatë. Pra, për shkak të lidhjes midis procedurës penale dhe kësaj çështjeje civile, parashtruesi i kërkesës propozoi ndërprerjen e procesit deri në përfundimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Gjakovë.
14. Në kërkesën e tanishme KI87/23, parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ.nr.113/2022], të 27 dhjetorit 2023, i cili ndërlidhet me procedurën sipas padisë për anulimin e Aktvendimit të KPMM-së, nr. 3777, të 31 gushtit 2017.
- i) Përbledhja e fakteve lidhur me rastin e tanishëm KI87/23, përbledhja e fakteve lidhur me procedurën sipas padisë për anulimin e Aktvendimit nr. 3777, të KPMM-së, të 31 gushtit 2017**
15. Më 31 gusht 2017, KPMM përmes Aktvendimit [nr. 3777], i shqiptoi parashtruesit të kërkesës gjobën administrative në shumë prej 9,693.86 EUR, për shfrytëzimin e jashtëligjshëm të resurseve minerare dhe zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar pa posedimin e licencës së shfrytëzimit.
16. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në shkallën e dytë të KPMM-së.
17. Më 26 tetor 2017, shkalla e dytë e KPMM-së përmes Vendimit [KA.nr.086/2017], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Vendimin [Nr.3777], të 31 gushtit 2017, të KPMM-së.
18. Në një datë të pasaktësuar parashtruesi i kërkesë parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kundër KPMM-së, ku kërkoi që vendimi i KPMM-së të shpallet jo i ligjshëm.
19. Më 25 tetor 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykit [A.nr.1991/17] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.
20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve të rënda të dispozitive të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovojë si të bazuar ankesën e tij, ashtu që aktgjykit e ankimuar ta ndryshojë duke aprovar padinë e tij apo që atë Aktgjykit ta prishë duke e kthyer çështjen në rigjykit dhe rivendosje.

21. Më 20 shtator 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [A.A.nr.28/2022], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore e vërtetoi.
22. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ku kontestoi ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që kërkesa e tij të aprovohet duke e ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të Apelit dhe që kërkesëpacia e paditësit të aprovohet në tërsësi si e bazuar apo që aktgjykimet e kontestuara të prishen dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
23. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.113/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AA.nr.28/2022], të 20 shtatorit 2022.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjyki i kontestuar ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, duke aluduar në mos arsyetimin e vendimeve gjyqësore nga ana e Gjykatave të rregullta, ku siç pohon parashtruesi i kërkesës, Gjykatat e të tria niveleve fare nuk janë lëshuar në vlerësimin e pretendimeve ankimore të tij "... duke pasur parasysh provat e administruara në atë çështje, e cila ka qenë e ndërlidhur me procedurën administrative, vërtetojnë një gjendje tjetër faktike, gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë arsyefare në ato pretendime apo ne provat e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës, vetëm se kanë deklaruar se procedua penale është procedure e ndare nga ajo administrative, ndërsa aktgjykimet e tyre janë te bazuara tërësisht ne gjendje faktike. Askund nuk janë konstatuar gjetjet e provave te propozuara nga parashtruesi i kërkesës, ne asnjerin nga vendimet e gjykatave. Gjykata Themelore Prishtine, Departamenti për çështje Administrative, Gjykata e Apelit te Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës, kane sjelle vendime me terme te gjeneralizuar, pa arsyetuar fare pretendimet ankimore apo provat e administruara te prezantuara nga parashtruesi i kërkesës dhe gjetjet nga to".
26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se vendimet e gjykatave të rregullta kanë genë arbitrarë pasi që nuk i kanë shqyrtuar pretendimet e tij, duke pohuar se "... konstatimi i gjykatave se procedura administrative është e ndare nga procedura penale, vlen vetëm ne aspekt procedural, ne këtë çështje vendimet e gjykatave janë bazuar ne gjendje faktike. Ne arsyetimin e ankesave administrative dhe padisë nuk është atakuar aspekti procedural, i akteve administrative, por qe nga organi administrativ është vërtetuar një gjendje e gabuar faktike, prandaj nuk mund te këtë dy gjendje faktike një tjetër ne administrative e një tjetër ne penale". Parashtruesi i kërkesës përmend disa vendime të Gjykatës, duke theksuar se Gjykata ka një praktikë lidhur me vendimet e arsyetuara dhe duke cituar disa paragrafë të këtyre vendimeve.
27. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, pasi që siç thekson atij i është mohuar e drejta për mjete juridike nga ana e Gjykatës Themelore, pasi që Aktgjyki i Gjykatës Themelore nuk e ka përbajtur këshillën juridike.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gjëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

- 3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
- a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
 - b. t'i jepet koha dhe lehtësitet e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
 - c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të myftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
 - d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*
 - e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.*

Neni 79
Shqiptimi i Gjobave Administrative dhe Mjetet tjera Juridike

[...]

3. Nëse një Person shfrytëzon ose eksplotaton minerale në mënyrë të paligjshme, KPMM do ti shqiptojë këtij personi një gjobë që është e barabartë me trefishin e shumës së rentave minerare të cilat duhet të paguhen për mineralet e shfrytëzuara ose eksplotatuara. KPMM do të krijojë një metodologji të arsyeshme përllogaritjen e sasisë së mineraleve të shfrytëzuara ose eksplotatuara në mënyrë të paligjshme dhe do ta caktojë gjobën e lartpërmendur në përputhje me këtë metodologji.

4. Nëse një person zhvillon aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta pa poseduar Licencën ose Lejen e nevojshme, KPMM do të nxjerrë urdhër përmes të cilit i shqipton këtij Personi një gjobë në shumën prej pesëmijë (5000) Euro për secilin aktivitet të këtillë.

5. Gjobat monetare dhe mjetet juridike të përcaktuara në këtë nen janë kumulative (grumbulluese) dhe KPMM do të nxjerrë të gjitha urdhrat e nevojshme për shqiptimin ndaj Personit(ave) përkatës të të gjitha gjobave dhe mjeteve juridike të zbatueshme.

Neni 80
Dënimet Penale për Aktivitet e Jashtëligjshme Minerare

1. Çdo personi i cili angazhohet ose i cili inkurajon ose punëson persona tjerë për t'u angazhuar në aktivitete të shfrytëzimit ose hulumtimit të mineraleve pa posedimin e një Licence ose Leje nga KPMM, i shqiptohet gjoba administrative e përcaktuar në paragrafin 2. nën-parografi 2.1. të nenit 79 të këtij ligji dhe një masë burgimi deri në gjashtë (6) muaj.

2. Çdo ndërmarrje e cila punëson ose inkurajon persona fizik që të angazhohen në aktivitete të shfrytëzimit ose hulumtimit të mineraleve - dhe kjo ndërmarrje nuk zoteron një Licence ose Leje të marrë nga KPMM - i shqiptohet gjoba administrative e përcaktuar paragrafin 2. nën-parografi 2.2. të nenit 79 te këtij ligji. Përveç kësaj, çdo udhëheqës i lartë i ndërmarrjes i cili ka pasur njohuri mbi këto aktivitete të shfrytëzimit ose hulumtimit – ose nëse do të kishte ushtruar kujdes të arsyeshëm menaxherial do të kishte qenë në njohuri mbi këto aktivitete të shqyrtimit ose hulumtimit – i shqiptohen masat administrative dhe penale të përcaktuara në paragrafin 1 te këtij neni.

LIGJI NR. 04/L-158 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-163 PËR MINIERAT DHE MINERALET

Neni 49

Neni 80 i ligjit bazik, parografi 1. pas fjalës “mineraleve“ shtohet togfjalëshi “dhe lejet për aktivitetet e veçanta“.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

30. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

31. Përkitazi me përbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr. 113/2022] e 27 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
32. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.

33. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsy që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjtë vlerëson se përbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmiye Makollë*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
34. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nën kriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrëthanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrëthana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjyktimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, Vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
35. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
36. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë në atë se parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me gjobë në vlerë prej 9,693.86 EUR nga ana e KPMM-së për shkak të shfrytëzimit të jashtëligjshëm të resurseve minerare dhe zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm

minerar pa posedimin e licencës së shfrytëzimit. Parashtuesi i kërkesës ishte ankuar në shkallën e dytë të KPMM-së lidhur me gjobën e shqiptuar, ku ankesa e tij ishte refuzuar dhe vendimi i shkallës së parë i KPMM-së ishte lënë në fuqi. I pakënaqur me vendimin e shkallës së dytë të KPMM-së parashtuesi i kërkesës kishte parashtuar padi në Gjykatën Themelore, ku kjo e fundit e kishte refuzuar padinë si të pabazuar. Kundër vendimit të Gjykatës Themelore parashtuesi i kërkesës kishte parashtuar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila ankesë ishte refuzuar dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte vërtetuar. Parashtuesi i kërkesës kishte parashtuar kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, e cila kërkesë ishte refuzuar nga ana e Gjykatës Supreme.

37. Gjykata rikuhton se parashtuesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
38. Gjykata verën se esenca e pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, ndërlidhet me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Gjykata vlerëson se pretendimet e tillë ngrenë çështje nga neni 31.1 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Sa i përket pretendimit për vendim të pa arsyetuar gjyqësor

39. Gjykata rikuhton se parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij pranë Gjykatës, në esencë, pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës për shkak të mos arsyetimit të Aktgjykit të ana e gjykatave të rregullta. Pra, parashtuesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë faktet dhe provat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, pasi që "... duke pasur parasysh provat e administruara në atë çështje, e cila ka qenë e ndërlidhur me procedurën administrative, vërtetojnë një gjendje tjeter faktike, gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë arsyen fare në ato pretendime apo ne provat e prezantuara nga parashtuesi i kërkesës, vetëm se kanë deklaruar se procedua penale është procedure e ndare nga ajo administrative, ndërsa aktgjykimet e tyre janë te bazuara tërësisht ne gjendje faktike. Askund nuk janë konstatuar gjetjet e provave te propozuara nga parashtuesi i kërkesës, ne asnjërin nga vendimet e gjykatave. Gjykata Themelore Prishtine, Departamenti për çështje Administrative, Gjykata e Apelit te Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës, kanë sjelle vendime me terme te gjeneralizuar, pa arsyetuar fare pretendimet ankimore apo provat e administruara te prezantuara nga parashtuesi i kërkesës dhe gjetjet nga to".
40. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet Hadjianastassiou kundër Greqisë nr.12945/87, Aktgjykim, i 16 dhjetorit 1992; Van de Hurk kundër Holandës, Aktgjykim, i 19 prillit 1994; Hiro Balani kundër Spanjës nr.18064/91, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994; Higgins dhe të tjerët kundër Francës nr.134/1996/753/952, Aktgjykim, i 19 shkurtit 1998; Garcia Ruiz kundër Spanjës nr.30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999; Hirvisaari kundër Finlandës

nr.49684/99, Aktgjykim, i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundér Finlandës* nr.37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; dhe *Tatishvili kundér Rusisë* nr.1509/02, Aktgjykim, i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim, i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim, i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019; si dhe rastin [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

41. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japid arsyen e mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundér Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
42. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përbajnjë arsyetimet në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsyen mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrëthanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundér Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundér Spanjës*, Aktgjykim, i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundér Francës*, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18 IF Skadeforsikring](#), të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkuption që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplikite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundér Portugalisë* nr.19867/12, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"*, Aktgjykim, i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
43. Gjykata me këtë rast rikujton se KPMM fillimisht, kishte gjobitur parashtruesin e kërkesës për shkak të shfrytëzimit të jashtëligjshëm të resurseve minerare dhe zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar pa posedimin e licencës së shfrytëzimit. Vendimi i KPMM-së ishte vërtetuar edhe nga shkalla e dytë e KPMM-së e cila kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e kishte vërtetuar vendimin e KPMM-së.
44. Gjykata Themelore, duke shpallur si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, përmes të cilës ishte kërkuar anulimi i Aktvendimit [KA.nr.086/2017], të 26 tetorit 2017, të KPMM-së, ndër të tjera kishte theksuar si në vijim:

"Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit te goditur me padi, ne përputhje me nenin 44 te LKA-së dhe provave te administruara ne seancën e shqyrimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Me aktvendimin e shkalles se dyte te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale KA.nr. 086/2017 i dt. 26.10.2017 te goditur me padi, është refuzuar ankesa dhe ka mbetur ne fuqi vendimi Nr.3777 i datës 31.08.2017 ne shumen prej (9,693.86) euro.

Paditësi i pakënaqur me këtë aktvendim ka parashtruar padi ne këtë gjykate me te cilin e ka kundërshtuar ligjshmérinë e te njëjtë. Gjykata duke vlerësuar ligjshmérinë e aktvendimit te goditur me padi, iu referua Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minierat dhe Mineralet (LMM), konkretisht nenit 79 paragrafit 3 dhe 4 i cili përcakton se: " Nëse një Person shfrytëzon ose eksplaoaton minerale ne mënyrë te paligjshme, KPMM do ti shqiptoje këtij personi një gjobe që është e barabarte me trefishin e shumes se rentave minerare te cilat duhet te paguhen për mineralet e shfrytëzuara ose eksplaoatuara. KPMM do te krijoje një metodologji te arsyeshme për përllogaritjen e sasisë se mineraleve te shfrytëzuara ose eksplaoatuara ne mënyrë te paligjshme dhe do ta caktoje gjobën e lartpërmendur ne përputhje me këtë metodologji. Nëse një person zhvillon aktivitete te hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete te veçanta pa poseduari Licencën ose Lejen e nevojshme, KPMM do te nxjerre urdhër përmes te cilit i shqipton këtij Personi një gjobe ne shumen prej pesëmijë (5000) Euro për secilin aktivitet te këtillë". Ndërsa ne pjesën e VI te këtij ligji, janë parapare procedurat e kërkesës, kohëzgjatjes dhe fushëveprimit te lejes për aktivitete te veçanta, ku në paragrafin 1 te nenit 37, përcaktohet se: "Kohëzgjatja dhe fushëveprimi i çdo leje përcaktohet nga KPMM-ja ne mënyre te arsyeshme dhe te drejtpërdrejte dhe racionale ne lidhje me ushtrimin e aktiviteteve te veçanta te autorizuara me Lejen ne fjale" Ne baze te raporteve te operimit ilegal te datës 20.04.2018,dhe fotot ne vendin e ngjarjes është konstatuar se ankuesi tanë paditësi është operues ilegal i shfrytëzimit resurseve minerale pa posedim te Licencës se shfrytëzimit nga KPMM dhe ne kundërshtim me nenin 79. par.3, 4 dhe 5 te Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale. Lidhur me këtë dhe dispozitat e ligjit te lartcekur, gjykata vlerëson se dispozita ligjore janë aplikuar drejte nga ana e te paditurës ne procedurën administrative dhe se arsyetimi i vendimit është i bazuar ne vërtetimin e plote dhe te drejte1:e gjendjes faktike".

45. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykit [AA.nr.28/2022] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Aktgjykitin e Gjykatës Themelore e vërtetoi. Në arsyetimin e Aktgjykitit ndër të tjera theksoi:

"Qëndrimin juridik te gjykatës se shkalles se pare, si të rregullt dhe te bazuar ne ligj ne tërësi e pranon edhe kjo gjykate, për arsy se aktgjykimi i ankumuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore te dispozitave te Ligjit për Konfliktet Administrative, te cilat shkelje gjykata e shkalles se dyte i heton sipas detyrës zyrtare ne baze te nenit 194 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, te aplikueshëm sipas nenit 63 te Ligjit për Konfliktet Administrative.

Andaj, ne baze te raportit te Inspektimit te Aktivitetit te Jashtëligjshëm te datës 11.08.2017, Urdhëresës për Ndërprerjen e Aktivitetit te Jashtëligjshëm Minerar te datës 11.08.2017, Raportit për operim ilegal date 24.08.2017, vërehet se inspektoret e te paditurës kane konstatuar se Shpëtim Bokshi ka bere shfrytëzimin ilegal te rërës dhe zhavorrit ne vend shfrytëzimin ne Doblibare pa Licence na KPMM-ja, dhe me qellim te ndërprerjes se këtij aktiviteti ishte lëshuar Urdhëresa me dt.11.08.2017, sipas te cilës paditësi urdhërohet qe menjëherë te ndërpër operimin ilegal, dhe me pas ishte nxjerr rapporti i kalkulimit te vëllimit sipas te cilit vërehet se ishte llogarit sasia e mineraleve te shfrytëzuara nga paditësi e qe ishe 1251.695 m³, ne fushën e shfrytëzimit 791.367 m².

Ne raport me pretendimin e paditësit ne ankesë lidhur me aktgjykitin e Gjykatës Themelore ne Gjakove P.nr.922/2017, se paditësi është liruar ngaakuza për veprën penale për të cilën është akuzuar, këtë pretendim Kolegji i Apelit e refuzoj si te pa bazuar përfaktin se, procedura penale është procedure e ndare dhe e veçantë nga procedura ne konfliktin administrativ andaj këto dy çështje janë te

ndara dhe zhwillohen pavarësisht njëra tjetërës, ne konflikt vlerësohet ligjshmëria e aktit përfundimtar ne procedure administrative.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkalles se pare ka bere shkelje te dispozitave procedurale. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate i vlerëson si te pa bazuara, nga se gjykata e shkalles se pare e ka shqyrtuar padinë, fillimi i ka dërguar padinë përfaqësuesit te se paditurës ne përgjigje ne padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së. Po ashtu gjykata ka vlerësuar drejtë se paditësi nuk ka pasur leje të aktivitetit të veçantë, dhe është vërtetuar se paditësi, është hasur duke kryer operimin ilegal në lokacionin dhe koordinatat si në raport të inspektimit të paditurës”.

46. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.113/2022] po ashtu kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, ku ndër të tjera kishte theksuar:

“Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tille e çështjes pas ekzaminimit te aktgjykimit te kontestuar dhe shkresave tjera te lendet gjen se, gjykata e shkalles se dyte ka vepruar drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin si të pabazuar të ankesës se paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së pare. Qëndrimin juridik te Gjykatës se Apelit por edhe te Gjykatës Themelore, ne tërësi e aprovon edhe kjo gjykate, meqë aktgjykimet e kontestuar nuk janë te përfshire me shkelje të dispozitave te procedurës apo te drejtës materiale ashtu si pretendon paditësi në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përbajnjë arsyte te mjaftueshme dlië bindëse për te gjitha faktet vendimtare te vlefshme për gjykimin e drejtë te kësaj çështje te cilat i aprovon edhe kjo gjykate.

Pretendimet e paditësit në kërkesë te cekura si me larte dhe theksimet ndër te tjera ne arsyetim se është aplikuar gabimisht e drejta materiale sepse nuk janë administruar shkresat penale ne këtë çështje ku paditësi është liruar ngaakuza, se nga gjykata e shkalles se pare nuk janë shqyrtuar pretendimet e paditësit sepse nuk është vërtetuar se kush e ka bere shfrytëzimin e mineral eve andaj paditësit i janë cenuar te drejtat nga nenin 31 i Kushtetutës ,se gjykata e shkalles se pare nuk i ka dhënë udhëzimi për ankim-këshilla juridike, etj., kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi ne tërësi ne baza ligjore dhe i vlerëson se, nuk janë te bazuara dhe te qëndrueshme sepse aktgjykimi i shkalles se pare dhe ai i shkalles se dyte janë te qarte ne dispozitiv, nuk janë ne kundërshtim me vetvete dhe te arsyetuar mjaftueshëm për te gjitha faktet vendimtare relevante te ngritura nga pala paditëse për gjykimin e drejtë te kësaj çështje, te cilat arsyte si te drejta dhe te plota i pranon edhe jo gjykate, andaj nuk rezulton se te njëjtë janë te përfshire me shkelje qenësore nga nenin 182 par. 1 dhe 2 te LPK ,si pretendon paditësi. Pretendimet si në kërkesë janë paraqitur në shkallen e pare dhe me ankesë te cilat janë shqyrtuar gjykata e shkalles se dyte e cila jep arsyte te mjaftueshme, bindëse dhe duke ju referuar edhe bazave ligjore për te gjitha pretendimet ankimore te paraqitura me refuzimin e ankesës se paditësit te cilat arsyte i pranon edhe Gjykata Supreme. Në arsyetim te aktgjykimit provohet se në tërësi janë pranuar arsyet lidhur me faktet vendimtare te gjykatës se shkalle se pare, si te drejta dhe te ligjshme për te gjitha faktet vendimtare, përndryshe përsëritja e arsyeve te drejta dhe te njëjtë te gjykatës se shkalle se pare do te ishte e pa nevojshme”.

47. Gjykata vëren se të tria Gjykatat e rregullta, vërtetuan se Vendimi i KPMM-së ishte i ligjshëm pasi që ishte marrë në pajtim me dispozitat ligjore përkatësisht duke u bazuar në nenin 79 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit për Miniera dhe Minerale. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme po ashtu i dha përgjigje edhe pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur

me atë se ai është liruar për veprën e njëjtë në procedurë penale, duke sqaruar se aktakuza e ngritur ndaj tij ishte hedhë poshtë nga ana e gjykatës për shkak të parashkrimit absolut dhe se në procedurën e konfliktit administrativ objekt i shqyrtimit dhe vendosjes është vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit përfundimtar në procedurë administrative si në rastin konkret andaj kjo çështje është ndarë nga përgjegjësia penale, sipas objektit të shqyrtimit sepse në konflikt administrativ vlerësohet ligjshmëria e aktit përfundimtar.

48. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën pretendim të ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkuption që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplikite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij përrishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor drejtar Gjykatës Supreme, kishte theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar pretendimet e tij sepse nuk është vërtetuar se kush e ka bërë shfrytëzimin e mineraleteve andaj atij i janë cenuar të drejtat nga neni 31 i Kushtetutës, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë udhëzim për ankim – këshillë juridike. Të njëjtit pretendim të parashtruesit, Gjykata Supreme i ishte përgjigjur në Aktgjykimin e saj, ku kishte theksuar se nuk janë të bazuara dhe të qëndrueshme pretendimet e parashtruesit sepse aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qartë në dispozitiv dhe se janë arsyetuar mjaftueshëm për të gjitha faktet relevante të ngritura nga parashtruesi i kërkesës për gjykim të drejtë të kësaj çështje.
50. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet pér shkelje të nenit 32 të Kushtetutës

51. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës pér shkelje të drejtës së tij pér mjete juridike, pér shkak të mosdhënies së këshillës juridike nga ana e Gjykatës Themelore, ishte trajtuar nga ana e Gjykatës Supreme. Lidhur me këtë Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës kishte shfrytëzuar të drejtën e tij pér ankesë, gjë që vërtetohet edhe përmes Vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Supreme të cilat kishin shqyrta ankesën përkatesisht kërkesën pér rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës, dhe se me këtë vërtetohet se nuk i është mohuar e drejta e tij pér mjete juridike.
52. Thënë këtë, Gjykata konsideron se pretendimin pér shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, e ka elaboruar mbi bazën e nenit 31 të Kushtetutës, duke e ndërlidhur shkeljen e këtyre të drejtave themelore, me mos arsyetimin e vendimeve gjyqësore, pér çfarë Gjykata sa më sipër konstatoi se në ketë pjesë kërkesa duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në baza kushtetueses dhe rrjedhimisht e papranueshme, pér arsyet e lartcekura.
53. Prandaj, Gjykata konstaton se përkizati me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës pér shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 32 të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

54. Si përbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor, që bien në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së dytë (ii) të pretendimeve “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, andaj të njëjtat duhet të deklarohen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
55. Sa i përket pretendimeve pér shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”.
56. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 30 janar 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzie Istrefi Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

